



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2022:256649

Datë: 27.11.2024

Numri i dokumentit: 06514921

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurit H.H nga fshati P..., Komuna Sh..., për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së) dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të paraqitur nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1812/22 të datës 20.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, të hapur për publikun, i cili është mbajtur më datë 07.10.2024, në të cilin morën pjesë prokurori i shtetit Ardian Emini prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, të pandehurit H.H, mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare Av. Labinota Qosa - Ilazi dhe të dëmtuarit H.H, më datë 10.10.2024 mori dhe publikisht shpalli, kurse më datë 27.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

H.H, nga i ati R..., e ëma Xh... e gjinisë B..., i lindur më datë ... , në fshatin P..., Komuna Sh..., me vendbanim të njëjtë, me numër personal ..., i papunë, i martuar, ka të kryer shtatë klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. **Ka qenë në masën e ndalimit nga data 27.10.2022 ora 19:20 e deri me datë 29.10.2022 ora 15:00.**

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Sepse:

Me datë 27.10.2022, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “R.T” që gjendet në fshatin T..., Komuna Sh..., deri sa i dëmtuari H.H kishte qenë në punë zyrtare si roje e natyrës kishte hasur të pandehurin në prerje ilegale të drunjtëve, në atë mënyrë që i pandehuri H.H, me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit e kanos të dëmtuarin H.H, ashtu që e kanos me fjalë kërcënuese se “nëse vjen policia te dera jem dhe më vjen dënimi ku ta shoh veturën tënde në rrugë kam me ta kallë” me ç’rast ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri te i dëmtuari.

-Me këtë ka kryer veprën penale **Kanosja** nga neni 181 paragrafi 3 të KPRK-

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 5, 7, 17, 21, 38, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe 181 paragrafi 3 të KPRK-së, si dhe neneve 364, 452, 455 paragrafi 1 dhe 462 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të pandehurin e:

G J Y K O N

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast se gjatë periudhës verifikuese prej 2 (dy) vite, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht. Në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e ndalimit nga data 27.10.2022 ora 19:20 e deri me datë 29.10.2022 ora 15:00.

II. I dëmtuari H.H me adresë banimi në Rr. “L.e.P” Komuna e Sh... për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.

III. Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 (njëzet) euro si dhe për fondin e kompensimit të viktimave të dhunës shumën prej 20 (njëzet) euro, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

-II-

Në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, i pandehuri H.H:

LIROHET NGA AKUZA

Sepse:

Me datë 27.10.2022, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “R.T” që gjendet në fshatin T..., Komuna Sh..., i pandehuri sulmon personin zyrtar, roje i natyrës të dëmtuarin H.H në atë mënyrë që i njëjti derisa kishte qenë duke kryer detyrat zyrtare ashtu që pasi e kishte ndaluar duke prerë drunjte në mënyre ilegale i njëjti e sulmon fizikisht me një mjet “dru” mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, duke e goditur në gjoks të dëmtuarin, me ç’rast i njëjti nuk ka kërkuar tretman mjekësor.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale **Sulmi ndaj personit zyrtar** nga neni 402 paragrafi 1 të KPRK-së.
- I dëmtuari H.H me adresë banimi në Rr. “L.e.P” C.. e R..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko - civil.
- Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm më datë 20.12.2022, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1812/22, kundër të pandehurit H.H nga fshati P..., Komuna Sh..., për shkak të veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 të KPRK-së dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 të KPRK-së.

Me datë 07.10.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Ardian Emini prokuror në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, i pandehuri H.H, mbrojtësja e tij sipas detyrës zyrtare Av. Labinota Qosa - Ilazi dhe i dëmtuari H.H.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se: Në bazë të nenit 351 të KPP-së paraqesë fjalën përfundimtare, mbetem në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të veprave penale si në pikën I dhe II, të aktakuzës kundër të pandehurit H.H, për veprën penale

Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 1 të KPRK- së dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 të KPRK-së, ku pas administrimit të provave personale dhe materiale gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar se i pandehuri ka kryer veprat penale që i vihen në barrë dhe atë pas dëgjimit të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit, i cili qartë, ka treguar derisa ka qenë në vendin e tij të punës, gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka hasur të pandehurin H.H duke prerë dru në mënyrë ilegale dhe në ato momente i pandehuri e godet me një mjet – dru të dëmtuarin në gjoks në pjesën e majtë e pastaj përdorë edhe fjalë me përmbajtje kërcënuese ndaj të dëmtuarit, ku në atë çast te i dëmtuari ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri dhe se i dëmtuari si në deklaratën e dhënë në Polici, pastaj në Prokurori si dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka qenë konsistent në deklarinimin e tij dhe ka bërë përshkrimin e ngjarjes faktike si në pikën I dhe II të aktakuzës. Sa i përket dëshmitarit N.H i propozoj gjykatës që të njëjtit mos t'i fal besimin, pasi që i njëjti është në lidhje gjaku me të pandehurin. Ndërsa sa i përket deklaratës së të pandehurit H.H i njëjti me qëllim që ti ikë përgjegjësisë penale për veprat penale që e ngarkon aktakuza ka qenë kontradiktor me deklaratën e dhënë në Polici ku e ka pranuar që e ka kanosur të dëmtuarin dhe se në procesverbalin e përpiluar me datë 27.10.2022, e ka nënshkruar pa presion dhe me vullnetin e tij. Po ashtu edhe me provat materiale që janë të përshkruara në aktakuzë vlerësojmë se me veprimet e të pandehurit janë konsumuar elementet e veprës penale si në pikën I dhe II të aktakuzës dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj një sanksion penal sipas Kodit Penal në fuqi. Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese nuk u gjet, ndërsa si rrethanë rëndues të merret parasysh se i dëmtuari ka qenë në kryerjen e detyrave të tij zyrtare dhe i njëjti është sulmuar duke cenuar integritetin trupor të tij dhe është kanosur e fjalë kërcënuese ku i ka shkaktuar frikë.

I dëmtuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: e mbështesë fjalën e Prokurorit të Shtetit dhe paraqesë kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësja sipas detyrës zyrtare Av. Labinota Qosa - Ilazi në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se: Konform nenit 353 paraqesim fjalën përfundimtare duke deklaruar se qëndrojmë prapa gjitha deklarimeve të bëra si në seancat e kaluara duke përsëritur se prokuroria ka dështuar që para gjykatës të vërtetojë se i mbrojturi im të ketë kryer veprat penale të ngarkuara si në aktakuzë pasi që nga vet provat materiale që gjenden në këtë çështje penale vërtetohet edhe nga vet deklarinimet e dhëna nga pala e dëmtuar, qoftë në procedurë paraprake, por edhe në këtë shqyrtim gjyqësor deklarinime të cilat kanë qenë konfuzë të pa qartë dhe në përmbajtjen e

tyre kanë dëshmuar se pala hapjen e rastit kundrejt të mbrojturit e kam bërë nga fakti se i mbrojturi im me datën 27.10.2022 pasdite së bashku me kushëririn e tij N.H që në procedurën paraprake ishte intervistuar një herë si palë e dyshuar, ndërsa në shqyrtim gjyqësor i njëjti është dëgjuar si dëshmitar dhe se ky rast rrjedh vetëm si rezultat i një kundërvajtje. Andaj që i mbrojturi im nuk ka kryer veprat penale dëshmohet në mënyrë absolute nga dëshmia e dëshmitarit okular N.H i cili në të gjitha përgjigjet e tij kundrejt pyetjeve të mbrojtjes por edhe të pyetjeve të prokurorisë dhe gjykatës në mënyrë kronologjike, të qartë, koncize ka shpjeguar para gjykatës se i njëjti në ditën kritike ka qenë prezent me të pandehurin H.H që nga momenti i ardhjes së palës së dëmtuar e deri ne largimin e tij nga vendi i ngjarjes, duke shtuar se i mbrojturi im asnjëherë nuk e ka kërcënuar apo kanosur me fjalën e specifikuar në aktakuzë, bile i njëjti në seancën e datës 04.09.2024, si dëshmitar ka specifikuar se nuk ka dëgjuar që i njëjti ti ketë thënë palës së dëmtuar ndonjë fjalë kërcënuese por nuk e ka sulmuar apo goditur me dru ashtu siç pretendon prokuroria, për çka edhe si mbrojtje ashtu siç kemi kërkuar në seancën e kaluar, por edhe sot ri përsërisim se gjykata duhet të ja falë besimin dëshmisë së dëshmitarit pasi që dëshmia e tij e dhënë në gjykatë është në përputhje të plotë edhe me dëshminë e tij të dhënë në cilësi të dyshuarit, ashtu që nuk ka vend për dyshim se i njëjti nuk ka deklaruar atë që ka dëgjuar dhe parë ditën kritike. Më tutje mbrojtësja ka deklaruar, se akti akuzues është i pabazuar në prova apo thënë me qartë është në kundërshtim me provat materiale në këtë çështje penale e dëshmon edhe procesverbali apo fletëparaqitja e rojës së pyllit e datës 27.10.2022 e cila mban numrin 09/22 pasi që nëse gjykata do ta lexojë përmbajtjen e kësaj fletëparaqitjeje i mbrojturi im ditën kritike nuk ka kanosur palën e dëmtuar pasi që në fletëparaqitje roja i pyllit në këtë çështje penale i njëjti askund nuk e ka nënvizuar se i mbrojturi im në ditën kritike të ketë kanosur me fjalët e specifikuara në aktakuzë apo të ketë sulmuar siç pretendon prokuroria, pasi që gjykata edhe prokuroria e dinë mirë se personat zyrtar në momentin që e përpilojnë dokument zyrtar siç është ky shënim i palës së dëmtuar asnjë moment nuk guxon që mos të evidentojë çdo veprim, deklaram apo fakt të ndodhur në ditën në bazë të cilën personat zyrtar mund të bëjnë kallëzime penale apo ankesa kundër personave të caktuar andaj gjykata nëse do t'i shikojë me kujdes edhe fotot e bashkangjitur do të vërtetojë se pala e dëmtuar në cilësinë e personit zyrtar – roje pylli as që ka shkrepur fotografi kundrejt të mbrojturit tim, atëherë kërkojë nga gjykata që ti administrojë veç e veç të gjitha dhe të gjitha së bashku dhe ti falë besimin dëshmisë së dëshmitarit N.H dhe në fund të këtij shqyrtimi të nxjerrë aktgjykim lirues kundrejt të mbrojturit tim duke bërë ashtu që të njëjtin ta lirojë nga përgjegjësia penale konform nenit 363 par. 1.3 në mungesë të provave të cilat janë administruar në këtë çështje penale.

I pandehuri në fjalën tij përfundimtare ka deklaruar se: E mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtëses time, me të dëmtuarin nuk kam asnjë problem privat, madje unë merrem me punën në ndërtimtari ndërsa nuk kam asnjë problem.

2.Provat e administruara

Në shqyrtim gjyqësor gjykata ka administruar provat si në vijim:

- Dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit H.H;
- Dëshmia e dëshmitarit N.H;
- Deklarata e të pandehurit H.H e dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022;
- Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit H.H e dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj me datë 20.12.2022 dhe në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022

Si dhe janë administruar provat materiale:

- Kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse me numër 04/03/09/65 e datës 25.11.2022;
- Fletëparaqitja e Rojës së Pyllit me numër 65/22 e datës 27.10.2022
- 3 (Tre) fletë të formatit A4 me fotografi;

Është refuzuar propozimi i prokurori të shtetit që të administrohet si provë deklarata personit N.H e dhënë në Stacion Policor me datë 27.10.2022, pasi që i njëjti këtë deklaratë e ka dhënë në cilësinë e të pandehurit po në këtë çështje penale, e gjithë kjo duke u bazuar në nenin 123 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së i cili përcakton se: *Si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje: “1.3. i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedurë e përbashkët apo e veçuar, përveç kur i bashkëpandehuri është dëshmitar bashkëpunues sipas nenit 231 të këtij Kodi”* si dhe neni 125 paragrafi 1 i KPP-së i cili përcakton se: deklarata është e papranueshme *“1. Dëshmia e dëshmitarit është e papranueshme nëse: 1.1. personi nuk mund të pyetet si dëshmitar”*.

I akuzuari e ka dhënë mbrojtjen e tij në shqyrtim gjyqësor.

2.1. Deklarata e të dëmtuarit- dëshmitarit H.H

I dëmtuari - dëshmitari H.H në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar: Unë përafërsisht që 3 vite punojë si roje pylli dhe atë që nga viti 2022 dhe atë në muajin Korrik apo Gusht, qëndrojë deklaratës së dhënë në Stacionin Policor dhe në Prokurorinë Themelore në Ferizaj dhe qëndrojë në tërësi pranë të dy deklaratave. Me datë 27.10.2022 kam qenë në terren në

vendin e quajtur “R.e.T” kam qenë vetë dhe diku rreth orës 14:00, unë kam hasur në personin N.H i cili ishte së bashku me të pandehurin tani, duke i bartur drunjte nga mali deri tek automjeti që e kishin për transport – motokultivator, unë kam shkuar tek vendi i ngjarjes ku kishin prerë drunjë kur më ka pa mua e ka ndërprerë punën dhe është ulur dhe e ka ndezur një cigare dhe ka biseduar me mua, kurse i pandehuri ka vazhduar prapë me punën që ka qenë duke e bërë dhe pas pak më ka vërejtur se jam aty dhe e ka ndërprerë punën dhe ka ardhur afër nesh dhe në dorë e kishte një dru 1 metër të gjatë dhe rreth 10 cm i gjerë dhe pa biseduar fare e ka ngrit drurin lartë dhe më ka goditur në anën e djathtë të kraharorit dhe i ka thënë N... “*qu kape nimom ta rrehim*” mirëpo N... nuk ka reaguar asgjë dhe i njëjti kur e ka marrë vesh se më ka goditur është ngrit në këmbë dhe i ka thënë të pandehurit pse e godite H... dhe unë jam larguar diku 4-5 metra dhe e kam thirrë në telefonin Stacionin Policor në Ferizaj dhe të njëjtit më kanë lidhur me Stacionin Policor në Shtime dhe unë e kam paraqitur rastin, mirëpo policia deri sa ka ardhur janë vonuar mbi 1 orë dhe unë vet kam shkuar në stacion për të dhënë deklaratë ndërsa N... ka qëndruar aty duke vazhduar punën me drunjë ndërsa i pandehuri është larguar nga vendi i ngjarjes nëpër pyll në anën që dërgon tek rruga kryesore për në shtëpi. Dua të shtoj se sa kam qenë aty kur i kam thirrë policinë i pandehuri më është drejtuar me fjalë kërcënuese se “nëse vie kjo fletëparaqitje dhe nëse vijnë policia te shpija unë ku ta shohë kerrin ty në rrugë kam me ta kall” dhe i njëjti më ka thënë “edhe natën kur të dalsh në punë kam me të ruajtur me kallash dhe kam me të vra”, kur mi ka thënë këto fjalë ka qenë prezent N... i cili i ka dëgjuar këto fjalë. Nga goditjet nuk kam pasur lëndime dhe nuk kam kërkuar ndihmë mjekësore mirëpo vetëm kam pirë një diklofen për shkak të dhimbjes. Të pandehurin para këtij rasti e kam hasur edhe herave të tjera duke prerë dru, mirëpo nuk është ndaluar, ka ikur nga vendi i ngjarjes ndërsa pas rastit më nuk e kam parë të njëjtin. Mesa e di H...e ka N... djalë të xhaxhait, gjatë punës sime si rojë pyllit kam pasur edhe raste të tjera kur më kanë kërcënuar dhe të njëjtat gjithmonë i kam paraqitur. Më tutje dëshmitari deklaroi se në polici kam deklaruar se N... është ulë dhe e ka ndezë një cigare, ndërsa kam bërë edhe fotografi në vendin e ngjarjes të cilat janë në shkresat e lëndës. Pasi më ka goditur i pandehuri unë jam larguar 4-5 metra për ta thirrë policinë dhe në atë interval kohor më ka kanosur me fjalët që i ceka më lartë. Unë kam dashur të ja marr motosharrën mirëpo nuk më kanë lejuar N... dhe i pandehuri, kurse motosharra ka qenë e të N... Unë e kam njohur të pandehurin si emër dhe si figurë i cili është H.H nga fshati P... dhe e ka gjendjen e dobët ekonomike i cili punon në ndërtim herë pas here dhe më tepër nuk e kam njohur, ndërsa personin N... e kam njohur si person i cili ka qenë dëmtues i pyjeve, kur kam pasur uniformën zyrtare veshur, fillimisht i kam thënë N... “ a je lodh dhe pse po pret dru” i njëjti e ka ndërprerë punën ka ndezë një cigare dhe është ulë dhe ka

thënë “dajë nuk po kam nga me ja mbajtë” ndërsa me të pandehurin nuk kam folur sepse i njëjti nuk ka pritur fare për të folur dhe ngjarja ka rrjedhë siç e kam cekur më lartë, i pandehuri pas 10 -15 minutave është larguar nga vendi i ngjarjes në mënyrë tinëzore ndërsa për këta 10 minuta me të pandehurin nuk kam folur asgjë ndërsa me N... dhe vëllain e tij i cili erdhi pas përfundimit të ngjarjes kam folur, të pandehurin nuk e kam takuar asnjëherë në pyll mirëpo vetëm në qytet e kam takuar, i njëjti as nuk më ka folur dhe nuk i kam folur, dhe nga fjalët që i kam cekur më lartë jam ndjerë i shqetësuar dhe i rrezikuar, pylli ku ka ndodhur ngjarja ka qenë publik dhe unë për këtë kam bërë fletëparaqitje ndaj N... dhe e kam potencuar edhe tani të pandehurin sepse ka qenë prezent.

2.2. Deklarata e dëshmitarit N.H

Dëshmitari N.H në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: Më kujtohet deklarata e dhënë në Stacionin Policor dhe qëndrojë pranë saj. Në ditën kritike unë kam qenë në mal, në rajonin R.e.T dhe aty kam qenë me vëllaun tim A... dhe me H.H dhe aty kemi qenë duke prerë drurë për nevoja personale dhe ajo pronë ka qenë shtetërore. Ka ardhur roja i pyllit dhe më ka kërkuar motorr-sharrën dhe unë nuk i’ a kam dhënë dhe roja i pyllit ka ecur në shtëpi. Roja i pyllit ka folur me mua dhe më ka thënë se nuk bënë me prerë drunjë ndërsa unë i kam thënë po më duhet të preje se nuk po kam nga me ja mbajtë ndërsa pjesa tjetër nuk më kujtohet. Iniciativën për të shkuar në pyll e kam marrë unë. Roja i pyllit më ka njoftuar që po bën procesverbal lidhur me prerjen e drunjtëve. Kur ka ardhur roja i pyllit H... nuk ka pasur e as më vonë nuk ka pasur asgjë në dorë dhe nuk e ka goditur H.... rojën e pyllit. Distanca mes nesh dhe rojës së pyllit ka qenë 1 – 2 metra, H... nuk ka biseduar me rojën e pyllit pasi që drutë kanë qenë të mijat. Rojën e pyllit e kam njohur dhe e ka ditur që është roje i pyllit. I pandehuri H.H nuk ka pasur diçka në dorë dhe as nuk i ka thënë të dëmtuarit H..., nëse vjen policia te shtëpia dhe më vjen ky dënim me pagu ku ta shohë veturën tënde në rrugë ka me ta kallë. Prej momentin kur ka ardhur roja e pyllit e deri në momentin që ka shkuar roja e pyllit, H... nuk ka folur asgjë me rojën e pyllit, ndërsa roja i pyllit nuk ka thënë se do ta shkruaj në fletëparaqitje H... I pandehuri H.H as nuk është vërsulur nga i dëmtuari dhe as nuk e ka goditur të dëmtuarin me dru. Vëllai im ka qenë prezent gjatë tërë kohës, i njëjti tani jeton në shtetin e Gjermanisë, H... më ka thënë mua “Hajde ecim në shtëpi” ndërsa diçka tjetër nuk më ka thënë, e as për të dëmtuarin nuk më ka thënë asgjë.

3. Mbrojtja e të akuzuarit

I pandehuri në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se: është e vërtetë se në ditën kritike kam qenë në vendin e quajtur “R.e.T”, kam qenë duke i ndihmuar kushëritit tim N.H i cili ishte duke prerë dru dhe unë e kam ndihmuar për shkak se ja kisha borxh dhe kisha një obligim ndaj tij, ndërkohë ka ardhur roja i pyllit, ndërsa roja i pyllit ka pasur punë me N..., ndërsa unë jam tërhequr se nuk ka pasur punë me mua. Roja e pyllit më ka pyetur se të kujt janë drunjtë, unë kam thënë se janë të kushëritit, ndërsa unë jam tërhequr dhe nuk kam folur më. Nuk e kam kërcënuar rojën e pyllit dhe as nuk e kam sulmuar. Drurët i ka prerë N..., ndërsa unë vetëm i kam bartur nga vendi ku i ka prerë deri ku i ka grumbulluar, në momentin kur ka ardhur roja i pyllit nuk kam pasur asgjë në dorë. Në stacionin Policor në Shtime kam dhënë deklaratë, dhe se nënshkrimi i është i imi, është e vërtetë se unë nuk i kam thënë të dëmtuarit se do t’ia kalli veturën, ndërsa nuk e di se çfarë kanë shkruar në polici, por unë nuk e kam thënë. Pranë deklaratës së dhënë në Stacionin Policor me datë 27.10.2022 nuk qëndroj sepse nuk e di se çfarë ka shkruar në polici, unë nuk e kam lexuar deklaratën, por polici më ka thënë nënshkruaje dhe unë e kam nënshkruar. Nuk e kam nënshkruar deklaratën me vullnet të lirë se nuk e kam ditur se çfarë kanë shkruar, vetëm më kanë thënë nënshkruaje, ndërsa nuk kam pasur presion, vetëm më kanë thënë nënshkruaje se ne nuk merremi me ty, unë vetëm e kam nënshkruar dhe kam ecur. Kur ka ardhur i dëmtuari, më ka thënë se po të shkruaj, ndërsa unë i kam thënë që mos më shkruaj, ndërsa nuk më ka ardhur asnjë letër – dokument lidhur me prerjen e drunjtëve.

4. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata bazuar në nenet 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të njëjtit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç ‘rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari H.H e ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 të KPRK-së, ndërsa nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 paragrafi 1 të KPRK-së dhe i njëjti është liruar nga akuza për këtë pikë.

Është fakt jo kontestues nga palët në procedurë se i akuzuari ditën kritike ka qenë në vendin e quajtur “R.e.T” që gjendet në fshatin T..., Komuna Sh... dhe se aty ka qenë edhe i dëmtuari H.H në cilësinë e personit zyrtar, roje i natyrës.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit dhe nga kjo dëshmi gjeti se i njëjti në mënyrë kronologjike e kishte shpjeguar ngjarjen e ditës kritike ku i njëjti në ditën kritike kishte hasur të akuzuarin H.H dhe dëshmitarin N.H ku kishin prerë drunjë dhe N... ka ndërprerë punën dhe është ulur dhe e ka ndezur një cigare, ndërsa i akuzuari i është drejtuar me fjalët kërcënuese se “nëse vjen kjo fletëparaqitje dhe nëse vijnë policia te shtëpia unë ku ta shohë kerrin ty në rrugë dhe kam me ta kall”, ndërsa sa i përket pjesës ku i dëmtuari ka deklaruar që i akuzuari e ka ndërprerë punën dhe ka ardhur afër nesh dhe në dorë kishte një dru 1 metër i gjatë dhe rreth 10 cm i gjerë dhe pa biseduar fare e ka ngrit drurin lartë dhe e ka goditur të dëmtuarin në anën e djathtë të kraharorit, gjykata nuk i’a fali besimin duke u mbështetur në faktin se nga provat e lartshënuara nuk gjeti një ndërlidhje për të provuar se i akuzuari e ka ndërmarrë një veprim të tillë.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin dëshmisë së dëshmitarit N.H dhe nga e njëjta gjeti se i njëjti në ditën kritike ka qenë së bashku me të pandehurin në vendin e quajtur “R.e.T” së bashku me A... (vëllain e tij) dhe H..., ka biseduar me të dëmtuarin – rojën e pyllit i ka dorëzuar motorsharrën e ka njoftuar që është duke mbajtur procesverbal lidhur me prerjen e drunjëve dhe i pandehuri nuk ka pasur asgjë në dorë në ditën kritike. Ndërsa sa i përket pjesës së dëshmisë ku ka theksuar se i akuzuari nuk ka folur asgjë me të dëmtuarin dhe se nuk e ka kanosur me fjalët “nëse vjen policia te shtëpia dhe më vjen ky dënim me pagu ku ta shohë veturën tënde ka me ta kall” pasi që kjo pjesë e dëshmisë është në kundërshtim me provat tjera të administruara, ku edhe vet i akuzuari nuk e ka mohuar se ka komunikuar me të dëmtuarin madje në deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022 ka theksuar se i kam thënë të dëmtuarit se “nëse vjen policia te shtëpia dhe më vjen ky dënim me pagu ku ta shohë veturën tënde në rrugë ka me ta kall”, dhe ka theksuar se këto fjalë ia ka thënë të dëmtuarit pasi që ka qenë nervoz.

Gjykata ia fali pjesërisht besimin mbrojtjes së të akuzuarit dhe nga e njëjta gjeti se ditën kritike së bashku me dëshmitarin N.H ka qenë në vendin e quajtur “R.e.T” në fshatin T..., komuna Sh... dhe se aty ka shkuar roja i pyllit H.H dhe se të njëjtin nuk e ka sulmuar, ndërsa nuk ia fali

besimin pjesës së deklaratës ku në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk e ka kanosur të dëmtuarin pasi që një deklaram i tillë është në kundërshtim edhe me vetë deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022, ku ka theksuar se i kam thënë të dëmtuarit se *“nëse vjen policia te shtëpia dhe më vjen ky dënim me pagu ku ta shohë veturën tënde në rrugë ka me ta kall”*, dhe ka theksuar se këto fjalë ia ka thënë të dëmtuarit pasi që ka qenë nervoz dhe kur është ballafaquar me deklaratën e dhënë në Polici ka deklaruar se nënshkrimi është i tij dhe se nuk ka pasur presion për ta dhënë një deklaratë të tillë, kurse tutje ka deklaruar se nuk e ka nënshkruar me vullnet të lirë, pra i njëjti ka qenë konfuz për arsyet se pse e kundërshton këtë deklaratë dhe gjykata e ka vlerësuar se deklarimi i të njëjtit në Stacion Policor është në përputhje me provat e administruara e sidomos edhe me dëshminë e të dëmtuarit – dëshmitarit H.H.

Nga kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse me numër 04/03/09/65 e datës 25.11.2022, gjykata gjeti se i dëmtuari ka paraqitur kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtëse për dëmin pyjor kundër dëshmitarit N.H dhe si bashkëveprues për dëmin pyjor ka konstatuar H.H.

Nga Fletëparaqitja e Rojës së Pyllit me numër 65/22 e datës 27.10.2022, gjykata gjeti se i dëmtuari ka paraqitur N.H dhe H.H si dëmtues të pyllit.

Nga tri fletë të formatit A4 me fotografi, gjykata gjeti se në ditën kritike janë konstatuar dëmtime të pyllit.

5. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: Me datë 27.10.2022, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “R.T” që gjendet në fshatin T..., Komuna Sh..., deri sa i dëmtuari H.H kishte qenë në punë zyrtare si roje e natyrës kishte hasur të pandehurin në prerje ilegale të drunjtëve, në atë mënyrë që i pandehuri H.H, me qëllim të frikësimit dhe shkaktimit të ankthit e kanos të dëmtuarin H.H, ashtu që e kanos me fjalë kërcënuese se *“nëse vjen policia te dera jem dhe më vjen dënimi ku ta shoh veturën tënde në rrugë kam me ta kallë”* me ç’rast ka shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri te i dëmtuari.

Neni 181 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkakttoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të*

shkaktimit të ankthit të personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.”. Kurse paragrafi 3 i po të njëjtit nen përcakton se: “Kur vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj personit zyrtar në lidhje me punën apo me pozitën e tij ose ndaj disa personave ose kur vepra kryhet nga kryesi i cili vepron si anëtar i grupit, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”. Andaj duke pasur parasysh se i akuzuari të dëmtuarit i është drejtuar me fjalët “nëse vjen policia te dera jem dhe më vjen dënimi ku ta shoh veturën tënde në rrugë ka me ta kall” i ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësim të dëmtuarit.

Se i akuzuari e ka kanosur të dëmtuarin është vërtetuar nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitarit H.H e dhënë në shqyrtim gjyqësor ku ka deklaruar se “nëse vie kjo fletëparaqitje dhe nëse vijnë policia te shpija unë ku ta shohë kerrin ty në rrugë kam me ta kall”, Të njëjtën dëshmi e ka dhënë edhe në deklaratën e dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj me datë 20.12.2022, si dhe në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022. Gjithashtu edhe vet i akuzuari në deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Shtime me datë 27.10.2022 ka theksuar se i kam thënë të dëmtuarit se “nëse vjen policia te shtëpia dhe më vjen ky dënim me pagu ku ta shohë veturën tënde në rrugë ka me ta kall”, dhe ka theksuar se këto fjalë ia ka thënë të dëmtuarit pasi që ka qenë nervoz.

Përveç elementeve të përgjithshme, gjykata gjen se në veprimet e të akuzuarit, janë përmbushur edhe elementet e veçanta të veprës penale. Kjo për faktin se i akuzuari e dinte se subjekti pasiv të cilin po e sulmonte, ishte person zyrtar, përkatësisht roje pylli, madje se i dëmtuari e kishte cilësinë e personit zyrtar e ka pohuar edhe vet i akuzuari. Gjithashtu, nga provat e administruara, nuk ishte fare kontestuese se i dëmtuari po ushtronte detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me ligj.

Andaj, nga të gjitha të lartcekurat gjykata vërtetoi se i akuzuari H.H e ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në diapozitivin I të këtij aktgjykimi.

7.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit t’i shqiptohet dënim të kushtëzuar me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në rast

se gjatë periudhës verifikuese prej një (2) vite, pasi aktgjykimi të marr formën e prerë, i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën gjykata do të revokoj dënimin me kusht, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të pandehurit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës. Gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që rrethanë lehtësuese për të pandehurin ka marrë faktin se është hera e parë që i pandehuri kryen veprë penale, faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, i papunë si dhe rrethanat personale dhe karakterin e tij të mirë para kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit për kryerjen e veprës penale.

Neni 79 paragrafi 1 i KPRK-së përcakton se: *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, burgim për të mitur, në masën edukative institucionale dhe dënimin me gjobë”*. Andaj, gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, në dënimin e shqiptuar të akuzuarit i është llogaritur edhe koha e kaluar në ndalim nga data 27.10.2022 ora 19:20 e deri me datë 29.10.2022 ora 15:00.

Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht përveç tjerash gjykata pati parasysh edhe qëllimin e dënimit me kusht e që në nenin 47 të KPRK-së përcaktohet se qëllimi i dënimit me kusht është që të mos zbatohet dënimi për vepra të lehta penale, kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e nevojshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë veprë penale. Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit të parapara në nenin 38 të KPRK-së e që konsistojnë në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

8.Vendimi për lirim nga akuza të akuzuarit për pikën II të aktakuzës

Neni 402 paragrafi 1 i KPRK-së lidhur me Sulmi ndaj personit zyrtar neni 402 par. 1 të KPRK-së përcakton se: *“Kushdo që sulmon ose kanoset seriozisht se do ta sulmojë personin zyrtar, apo personin i cili ndihmon në kryerjen e detyrave zyrtare, në lidhje me detyrat zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.”*. Pasoja e kësaj vepre, në kuptim të këtij inkriminimi, duhet kuptuar çdo veprim që krijon rrezik konkret dhe real për subjektin pasiv. Pasoja shkaktohet me vetë ndërmarrjen e veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale. A është ndërmarrë veprimi që mund të paraqesë sulm të një intensiteti të ulët, sepse një sulm që do të kishte shkaktuar lëndim trupor do të çonte në një formë tjetër të veprës penale, vlerësohet sipas kriterit objektiv, varësisht nga rrethanat konkrete të rastit e jo sipas përjetimeve subjektive të personit të dëmtuar. Andaj pasi që në rastin konkret nuk është provuar se i pandehuri me veprimet e tij ka sulmuar të dëmtuarin gjykata vendosi që të njëjtin ta liroj nga akuza si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në pikën I të dispozitivit të aktakuzës i akuzuari H.H është akuzuar se: Me datë 27.10.2022, rreth orës 15:30, në vendin e quajtur “R.T” që gjendet në fshatin T..., Komuna Sh..., i pandehuri sulmon personin zyrtar, roje i natyrës të dëmtuarin H.H në atë mënyrë që i njëjti derisa kishte qenë duke kryer detyrat zyrtare ashtu që pasi e kishte ndaluar duke prerë drunjtë në mënyre ilegale i njëjti e sulmon fizikisht me një mjet “dru” mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore, duke e goditur në gjoks të dëmtuarin, me ç’rast i njëjti nuk ka kërkuar tretman mjekësor. Mirëpo pas administrimit të provave gjykata gjeti se nuk është provuar se i akuzuari ta ketë ndërmarrë një veprim të tillë dhe atë i akuzuari e ka mohuar në të gjitha fazat e procedurës penale si dëshmitari N.H në mënyrë bindëse ka dëshmuar se i akuzuari nuk e ka sulmuar të dëmtuarin me dru dhe nuk e ka goditur fare. Kjo pikë e dispozitivit të aktakuzës është mbështetur vetëm në deklarinimin e palës së dëmtuar dhe si të tillë gjykata nuk mund ta shpallë fajtor të akuzuarin vetëm nga dëshmia e të dëmtuarit pa u mbështetur edhe në prova të tjera qoftë personale apo materiale.

Neni 20 i KPRK-së përcakton se: *“Personi nuk është penalisht përgjegjës kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojës mungon lidhja shkakore”*. Në këtë çështje penalo-juridike nuk është arritur të provohet përtej dyshimit të bazuar mirë se me cilat veprime nga ana e të pandehurit është i tij dhe a ka qenë dashja e të pandehurit e drejtuar drejtë sulmit të dëmtuarit. Gjithashtu, neni 3 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*. Gjykata nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor kur ka mëdyshje lidhur me faktet

kryesore, në këtë çështje penale Prokuroria, nuk ka ofruar prova me të cilat do të vërtetohej se i pandehuri ka ndërmarrë ndonjë veprim për të kryer veprën penale të lartcekur andaj gjykata në asnjë mënyrë nuk mund ta shpall të pandehurin fajtor duke u bazuar në një deklaratë të tillë.

Barra e provave i takon prokurorit të shtetit. Ai ka për detyrë që, me rastin e akuzimit të një personi, t'i parashtrijë gjykatës edhe provat me të cilat vërtetohet fajësia e tij. I pandehuri, përveç në rastin kur ligji shprehimisht e kërkon këtë prej tij, nuk është i detyruar të paraqesë prova me anën e të cilave do të provonte pafajësinë e vet. Qëndrimi eventual i kundërt, sipas të cilit i pandehuri do të ishte i detyruar të provojë se është i pafajshëm, e jo prokurori i shtetit, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Kodin e Procedurës Penale. Ana tjetër e manifestimit të prezumimit të pafajësisë konsiston në faktin që, po qe se në procedurën penale nuk arrihet të provohet fajësia, gjykata duhet ta lirojë të akuzuarin nga akuza.

Meqenëse nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale Sulmi ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.1 të KPRK-së, gjykata të njëjtin e liroi nga akuzua në bazë të nenit 363 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së.

9.Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Neni 462 paragrafi 2 i KPP-së përcakton se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mblidhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”* Andaj, pasi që nuk kishte një vlerë të saktë të kërkesës pasurore juridike dhe një veprim i tillë do ta zvarriste procedurën penale, gjykata duke u bazuar në dispozitën e lartcekur vendosi që të dëmtuarin për realizimin e kërkesës pasurore juridike ta udhëzoj në kontest të rregullt juridiko – civil.

10.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurin, gjykata duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që ta detyrojë të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzet) euro, si dhe duke u

bazuar në nenin 36 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të ligjit Nr. 08/L-109, për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej 20 (njëzet) Euro,

Bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së i cili përcakton se: *“Kur pushohet procedura penale apo kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza, gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 449, paragrafi 2 nën-paragrafi 2.1 deri në 2.5 të këtij Kodi, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimi i shpenzimeve të nevojshme të mbrojtësit paguhen nga mjetet buxhetore, përveç në rastet e caktuara në paragrafët vijues të këtij neni”*. Andaj gjykata vendosi që shpenzimet e procedurës sa i përket pikës II të aktakuzës të mbeten në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
2022:273866, me datë 27.11.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.